

Programi Y

MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Në Shkolla







**Monitorimi
dhe vlerësimi**

Program Y Monitorimi dhe vlerësimi në shkolla

Për të siguruar standarde të larta të implementimit, analiza të objektive, theksim të mundësive për të mësuar dhe zhvillim të mëtejshëm të Programit Y në shkollat e mesme, rekomandohet që monitorimi dhe vlerësimi të kryhen në baza të rregullta.

Monitorimi dhe vlerësimi janë pjesë integrale të programit dhe rekomandohet që stafi i shkollës t'ia delegojë këtë detyrë njërit prej anëtarëve të vet, për të monitoruar dhe vlerësuar programin, duke nisur nga fillimi.

Monitorimi duhet të kryhet në baza të rregullta. Ai duhet të përfshijë rishikimin e raporteve të shkurtra të seminareve dhe temave të përgatitura nga mësuesit dhe edukatorët bashkëmoshatarë, duke mbajtur shënime për numrin e pjesëmarrësve të përfshirë në program (duke përfshirë të dhëna të ndara në bazë gjinore), listën e pjesëmarrjes së të angazhuarve, duke përfshirë ata që kanë marrë pjesë në seminare dhe tema, si dhe në ngjarje të tjera të rëndësishme të shkollave.



Vlerësimi duhet të kryhet përmes:

1. Krahasimit mes vlerësimit të rezultateve të hulumtimit fillestar dhe hulumtimit përfundimtar (matjet e ndryshimit, i cili mund t'i atribuohet Programit Y).
2. Testimi paraprak dhe post-testimi (dija dhe qëndrimet).
3. Mbledhja e përshtypjeve (verbale ose me shkrim) nga nxënësit, mësime-dhënësit/et, prindërit dhe pala të tjera interesi të përfshira).
4. Xhirime audio dhe video të pjesëmarrësve përgjatë seminareve, temave dhe aktiviteteve të tjera të parapara.

Treguesit e mundshëm për matjen e progresit janë listuar më poshtë:

a) **Niveli i rezultateve** (si rezultat i kontributit direkt apo aktiviteteve të implementuara):

- › Numri i mësime-dhënësve/eve të trajnuar/a për implementimin e Programit Y.
- › Numri i seminareve të implementuara nga mësuesit dhe stafi i shkollës.
- › Numri i nxënësve/eve (Femra/Meshkuj) që kanë marrë pjesë në seminare e udhëhequra nga mësime-dhënësit/et.
- › Numri i aktiviteteve të temave të implementuara nga nxënësit dhe mësime-dhënësit/et.
- › Numri i aksioneve në komunitet të implementuara nga nxënësit dhe mësime-dhënësit/et.

b) **Niveli i rezultateve:**

- › Përqindja (%) e nxënësve të synuar (Femra/Meshkuj) që shfaqin dije dhe qëndrime të përmirësuara, të cilat lidhen me barazinë gjinore dhe jetesën e shëndetshme, si dhe dhuna e ndërsjellë e zvogëluar midis tyre.
- › Përqindja (%) e mësime-dhënësve/eve (Femra/Meshkuj) që raportojnë qëndrime të ndryshme, në lidhje me barazinë gjinore, si rezultat i drejtpërdrejtë i pjesëmarrjes në mësimin e Programit Y.

Rekomandime për hulumtimin fillestar dhe hulumtimin përfundimtar:

Hulumtimi fillestar – Qëllimi kryesor i hulumtimit fillestar është përshkrimi i situatës para fillimit të veprimit, në mënyrë që të jemi të aftë të vendosim bazën për monitorimin e progresit të projektit përgjatë rrugës, si dhe për të mbledhur të dhëna që do të përdoren në implementimin e programit në shkollë. Vlerësimet fillestare sigurojnë të dhëna për programin e përshtatshëm; dhe kjo është arsyeja pse ky hulumtim duhet të kryhet para çfarëdolloj ndërhyrjeje. Rezultatet e fituara sigurojnë njohuri mbi atë se ku duhet të përqendrohet fokusi i programit (për shembull, nëse hulumtimi fillestar tregon nivel të ulët të dijes, në lidhje me shëndetin seksual dhe riprodhues, si dhe kuptueshmëri të lartë të barazisë gjinore, atëherë ekipi implementues mund ta përshtatë programin dhe


veprimin në atë mënyrë që ai të jetë më i fokusuar dhe më kompleks në tema që lidhen me shëndetin seksual dhe riprodhues, si dhe shumë më pak në tema që lidhen me barazinë gjinore).

Hulumtimi përfundimtar – Qëllimi kyç i hulumtimit përfundimtar është të kontribuojë në një kuptueshmëri të plotë të progresit të përgjithshëm të programit, si dhe ndryshimet në njohuri, qëndrime dhe sjellje që lidhen me dhunën në përgjithësi dhe me dhunën me bazë gjinore, barazinë gjinore dhe jetesën e shëndetshme të djemve dhe vajzave, por gjithashtu edhe të mësimitdhënës/et dhe prindërit.

Vlerësimi i nivelit të njohurive, qëndrimeve dhe sjelljeve të grupeve të lartpërmendura duhet realizuar duke bërë hulumtime me pyetësorë të vetadministruar para implementimit të programit në shkollë, në mënyrë që të bëhet një krahasim dhe vlerësim i qëllimit të programit në vlerësimin përfundimtar, i cili duhet të bëhet pas implementimit të programit. Në këtë dokument do të gjeni raste hulumtuese për nxënës dhe mësimitdhënës/e, të cilët kanë pranuar të sigurojnë informacionin e nevojshëm, në lidhje me synimin e programit.

Përshkrimi i procesit:

- › Hulumtimi fillestar fillon para të gjitha aktiviteteve të programit. Duhet të kryhet në shtator/tetor, në fillim të vitit shkollor.
- › Madhësia e mostrës – hulumtimi fillestar duhet të bëhet me nxënës të vitit të parë (djem dhe vajza) dhe, nëse ka mundësi, me të gjithë nxënës të vitit të parë. Nëse kjo është e pamundur, stafi i shkollës mund të vendosë për madhësinë e mostrës përfaqësuese për shkollën e tyre.
- › Testimi i pyetësorit – para hulumtimit fillestar: testimi i pyetësorit duhet të bëhet me 5-10 nxënës, si pjesë e vlerësimit të kontekstit. Nëse ka pyetje, të cilat ata nuk i kuptojnë ose iu duken konfuze, stafi shkollor duhet të bëjë rregullimet e nevojshme dhe ta finalizojë pyetësorin, pas pranimit të përshtypjeve.
- › Kodimi – për ta matur ndryshimin në mënyrë të tërësishme. Rekomandohet që secili nxënës, si pjesëmarrës i hulumtimit, të marrë kodin e vet. Stafi shkollor, të cilit i është deleguar detyra, duhet të sigurohet që kodet të jenë në përputhshmëri me listën e nxënësve, por më e rëndësishmja është që konfidencialiteti i secilit të anketuar të respektohet pas përfundimit të hulumtimit.
- › Forma e pëlqimit – personi që realizon hulumtimin duhet të sigurohet që secili pjesëmarrës (ose prindërit e tyre) të nënshkruajnë formën e pëlqimit, që konfirmon vullnetin e tyre për të marrë pjesë në hulumtim. Nxënësit, të cilët nuk duan të marrin pjesë në hulumtim, nuk kanë nevojë ta nënshkruajnë formën e pëlqimit.
- › Lista e mekanizmave referuese – stafi shkollor duhet të sjellë një përshkrim për mekanizmat referuese apo mbështetëse ekzistuese që janë të qasshëm në shkollën e tyre dhe në komunitetin vendor, në mënyrë që të sigurohemi se pjesëmarrësit janë njohur me të.



- › Mbledhja e të dhënave – duhet gjithashtu të bëhet nga stafi me përvojë shkollore, siç janë sekretari i shkollës për pedagogji apo psikologët. Gjithashtu, shkolla i ka mundësitë t'i trajnojë nxënësit e viteve të fundit për t'u bërë mbledhës të të dhënave. Mbledhja e të dhënave mund të bëhet brenda 45 minutave, duke përdorur pyetësorin e zhvilluar, të prezantuar në këtë dokument (ju lutemi, shihni më poshtë), ku 10 minuta janë të rezervuara për prezantimin e qëllimit të hulumtimit, nënshkrimin e formës së pëlqimit, shpërndarjen e listës së mekanizmave referuese dhe pyetësorëve. Nxënësve zakonisht iu duhen 30-35 minuta për ta plotësuar pyetësorin, gjë që duhet të bëhet në qetësi dhe pa asnjë pengesë.
- › Analiza e të dhënave nënkupton procesin statistikor të të dhënave, e cila mund të bëhet përmes programeve të ndryshme statistikore. Programet më të përshtatshme të krijuara për këtë qëllim janë SPSS, R etj. Në mënyrë alternative, edhe Excel-i mund t'ju ndihmojë. Procesi statistikor i të dhënave më së shumti nënkupton kalkulimin e matjeve të thjeshta përshkruese, siç janë përqindjet apo mjetet e mundshme aritmetike. Është e nevojshme të ndahet procesi i të dhënave për djemtë dhe vajzat. Ne rekomandojmë që këtë punë ta kryejnë ekspertët, meqenëse ata tashmë kanë njohuri të caktuara statistikore. Të dhëna mbi karakteristikat e mostrës (gjinia, edukimi dhe punësimi i prindërve etj.) dhe të dhëna mbi fenomene konkrete, të cilat janë duke u vlerësuar (deklarata dhe pyetje mbi barazinë gjinore, dhunën, shëndetin seksual dhe riprodhues etj.) duhet të kalkulohen.
- › Raporti i hulumtimit – pas analizës së të dhënave, stafi shkollor duhet të zhvillojë një raport të shkurtër e të thjeshtë për të dhënat, dhe ta ndajë atë me bordin e shkollës, por gjithashtu ta përdorë për të planifikuar seminarët e ardhshme dhe aktivitetet e tjera shkollore.
- › Implementimi i programit – pasi të përfundojë hulumtimi fillestar, mund të fillojë implementimi i programit. Fillimisht me trajnime për mësimdhënës dhe edukatorë bashkëmohatarë. Si aneks në këtë dokument, mund të gjeni sugjerime për testet paraprake dhe post-testet për mësimdhënës dhe edukatorë bashkëmohatarë, të cilët, po ashtu, shërbejnë për të matur ndryshimin në njohuritë e tyre, qëndrimet dhe sjelljet.
- › Hulumtimi përfundimtar duhet të bëhet me nxënësit e viteve të fundit (me vitin e tretë ose të katërt), duke përfshirë të njëjtit nxënës nga hulumtimi fillestar (nga viti i parë). Duhet të përsërisni hapat e kodimit, të formës së pëlqimit, listën e mekanizmave referuese dhe, mundësisht trajnimin për mbledhjen e të dhënave. Është shumë e rëndësishme këtu që kodet të përputhen me nxënësit, në mënyrë që të identifikohen nxënësit që kanë marrë pjesë në hulumtimin fillestar.
- › Analiza e të dhënave – krahasimi i hulumtimit fillestar me atë përfundimtar. Ky proces nënkupton krahasimin e të dhënave nga hulumtimi fillestar me ato të hulumtimit përfundimtar. Analiza të ngjashme sta-

MBLEDHJA E TË DHËNAVE

ANALIZA E TË DHËNAVE

RAPORTI I HULUMTIMIT

IMPLEMENTIMI I PROGRAMIT

HULUMTIMI PËRFUNDIMTAR

ANALIZA E TË DHËNAVE

tistikore, si ato të të dhënave të hulumtimit fillestar, përdoren. Për më tej, do të ishte përfituese të kalkulohej të ashtuquajturat rezultatet e përmbledhjes për fenomene të caktuara, si barazia gjinore, dhuna e vazhdueshme, njohuria për shëndetin seksual dhe riprodhues etj. Është e dobishme të shihet, nëse ka dallime statistikore të dukshme në prezantimin e fenomeneve të tilla në hulumtimin fillestar dhe në atë përfundimtar. Teste statistikore, pa parametra për dy kampionet që lidhen, përdoren. Nëse përdoret SPSS, ato quhen Wilcoxon testi dhe NxNemar testi. Këto analiza shtesa nënkuptojnë njohuri më komplekse statistikore, kështu që ne rekomandojmë të merrni ndihmë nga një ekspert i statistikave.

- › Raporti i hulumtimit konsiston në disa pjesë. Një sesion i tabelës së përmbajtjes vjen menjëherë pas kopertinës së raportit, i përcjellë nga kapitulli prezantues. Raporti shpjegon problemet në komunitet, të lidhura me temën e projektit, përshkruan arsyen pse ky projekt është i nevojshëm, jep komponentët bazë të projektit dhe qëllimet e hulumtimit. Një kapitull i quajtur “Metodat” përshkruan: mostrën, për shembull, numrin e djemve dhe të vajzave, karakteristikat kryesore të familjeve të tyre (për shembull, edukimin, statusin financiar etj.), pyetësoin, procesin e hulumtimit, programin ndërhyrës, mënyrën si janë përpunuar të dhënat statistikore. Kapitulli vijues “Rezultatet” paraqet tabelën dhe interpretime të shkurtra me shkrim të rezultateve të fituara. Ne rekomandojmë që rezultatet të grupohen për fusha tematike. Pjesa “Shënime përmbyllëse” ose “Diskutime” përmban interpretim më të thelluar të rezultateve të fituara. Rekomandime të caktuara për punën në të ardhmen, si dhe konkluzionet, gjithashtu përfshihen në këtë sesion. Në fund, mundësisht hartohet një listë e literaturës së përdorur, nëse është përmendur në tekst.



RAPORTI I HULUMTIMIT

Mbledhja e të dhënave kualitative – nëse/dhe kur ka mundësi, mund të provoni të organizoni intervista me përfituesit e programit (nxënësit) dhe mësimdhënësit/et e prindërit e tyre. Në kuadër të këtyre intervistave, mund të fitoni shumë të dhëna, të cilat tregojnë ndryshimin e mundshëm dhe ndikimin e projektit, nga të cilat ju mund të ndërtoni raste studimi dhe tregime të suksesit, të cilat mund të përdoren për promovim të mëtejshëm të programit ose për ngritje të fondeve.

Ju rekomandojmë ta ndiqni procesin, siç është përshkruar këtu, si dhe të përdorni mjetet e ofruara, në mënyrë që ndikimi i programit të mund të matet në mënyrë të njëjtë në të gjitha shkollat në rajonin e Ballkanit ku ai implementohet. Në këtë kuptim, Ministritë e Arsimit mund të ndjekin dhe të shfrytëzojnë të dhënat ekzistuese dhe të eksplorojnë për mundësitë për ta përfshirë Programin Y në kurrikulën shkollore. Nëse ju duhet asistencë, ju lutemi kontaktoni organizatën partnere në shtetin tuaj. Paçi fat!

Aneksi 1

Pyetësi fillestar dhe përfundimtar
(testi paraprak dhe post-testi) për nxënësit.

Aneksi 2

Shembull i formës së pëlqimit

Aneksi 3

Shembull i listës së mekanizmave referuese

Aneksi 4

Testi paraprak dhe post-testi për mësimdhënës/e

Aneksi 5

Testi paraprak dhe post-testi për edukatorë
bashkëmoshatarë

Aneksi 6

Pyetësi kualitativ për intervista me prindër

Aneksi 7

Forma e raportimit për seminare dhe aktivitete
të temave

Aneksi 8

Shembull i bazës së të dhënave për nxënës dhe
mësues

Aneksi 1 Pyetësi fillestar dhe përfundimtar (testi paraprak dhe post-testi) për nxënësit.

PROGRAMI Y – Qasje Inovative në Parandalimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Promovimin e Jetesës së Shëndetshme të Burrave të Rinj dhe Grave të Reja

PYETËSOR PËR NXËNËS/E

Ky pyetësor përmban pyetje rreth fushave të ndryshme të jetës së nxënësve/eve të shkollave të mesme, siç janë shëndeti, dhuna, familja, raportet gjinore etj. Është e rëndësishme të jepen përgjigje të sinqerta në të gjitha pyetjet. Ky nuk është test i njohurive dhe nuk ka përgjigje të gabuara. Pyetësi mbushet në mënyrë të pavarur, duke rrumbullakosur apo shkruar përgjigjen e përshtatshme. **Pyetësi nuk duhet të nënshkruhet.**

Q 1. Seksi? a) Femër b) Mashkull

Q 2. Sa vjeç jeni? _____

RAPORTET GJINORE

Q 3. Ju lutemi, lexojini me kujdes deklaratat e mëposhtme. Duke shkruar me X në kutinë e përshtatshme, tregoni se deri në çfarë niveli pajtoheni me secilën prej deklaratave?

	DEKLARATA	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	Neutral	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Roli më i rëndësishëm i një gruaje është të jetë një amvisë e mirë, të kujdeset për shtëpinë dhe të gatujë për familjen e saj.					
2	Ndërrimi i pelenave, larja dhe ushqyerja e fëmijëve janë përgjegjësi të nënës.					
3	Nëse një grua e tradhton burrin, ai është i justifikuar nëse e godet gruan.					
4	Një shuplakë e vetme është formë e dhunës.					
5	Për një djalë, është më e pranueshme të largohet nga mësimi sesa për një vajzë.					
6	Burri duhet të ketë fjalën e fundit për vendimet e shtëpisë.					
7	Do ta pranoja, nëse kam një shok gej.					
8	Është normale kur një burrë e godet gruan e tij, nëse ajo nuk do (nuk dëshiron) të bëjë seks me të.					
9	Do të ndihesha shumë keq, nëse biri im do të ishte homoseksual.					
10	Gruaja duhet ta tolerojë dhunën, në mënyrë që ta mbajë familjen të bashkuar.					
11	Përgjegjësia ashtë e përbashkët, si e burrit edhe e gruas, për të parandaluar shtatzëninë.					
12	Është normale që burrat të qajnë e t'i shprehin emocionet e tyre para të tjerëve.					
13	Është e pranueshme të godas apo të rrah një person gej, nëse flirton me mua.					
14	Kur një grua ngacmohet seksualisht, kryesisht ndodh për shkak të mënyrës se si ajo është veshur.					
15	Është normale që prindërit t'i godasin fëmijët e tyre, kur ata/o nuk sillen mirë.					
16	Karakteristikat më të rëndësishme të një burri janë forca fizike dhe fuqia.					
17	Sharjet verbale janë lloj i dhunës.					

SHËNDETI

Q 4. A konsumoni duhan tani (rrumbullakosni)? a) Jo b) Po

Q 5. Sa shpesh konsumoni alkool?

- a) Kurrë
- b) Disa herë brenda vitit
- c) Disa herë brenda muajit
- d) Disa herë brenda javës
- e) Pothuajse çdo ditë

Q 6. Në tre muajt e kaluar sa shpesh keni konsumuar, pesë (5) ose më shumë pije alkoolike, në një rast të vetëm?

- a) Kurrë
- b) Më pak se një herë në muaj
- c) Rreth një herë në muaj
- d) Rreth një herë në javë
- e) Disa herë në javë

Q 7. Në tre muajt e kaluar sa herë keni konsumuar drogë (shkruani X në kutinë e përshtatshme)?

		Kurrë	Një ose dy herë	Më shumë se dy herë
1	Marihuanë			
2	Tjetër (Ju lutem, përshtatshme)			

Q 8. Miqtë tuaj të afërt, a konsumojnë ndonjëherë ose shpesh marihuanë apo droga të tjera (rrumbullakosni)?

- a) Jo
- b) Po

Q 9. Ju lutem, lexojeni secilën pyetje dhe shënoni me X poshtë përgjigjes gjendjen tuaj emocionale se si jeni ndjerë përgjatë muajit të kaluar

	DEKLARATA	Gjithë kohën	Shumicën e kohës	Nganjëherë	Rrallë	Kurrë
1	Sa herë gjatë muajit të kaluar jeni ndjerë nervoz?					
2	Sa herë gjatë muajit të kaluar jeni ndjerë i/e palumtur apo i/e mërzitur?					
3	Sa herë gjatë muajit të kaluar jeni ndjerë i/e qetë apo në paqe?					
4	Sa shpesh gjatë muajit të kaluar jeni ndjerë i/e dëshpëruar, aq sa asgjë nuk do të mund t'ju gëzonte?					
5	Përgjatë muajit të kaluar, sa herë jeni ndjerë i/e lumtur?					

Q 10. Nëse keni pasur marrëdhënie seksuale (kjo i referohet marrëdhënies tuaj të fundit seksuale), a keni përdorur kondom apo ndonjë formë tjetër të kontracepsionit (rrumbullakosni)?

- a) Ende nuk kam pasur marrëdhënie seksuale
- b) Nuk kemi përdorur kontracepsion
- c) Kemi përdorur kontracepsion

Q 11. Sa shpesh shkoni te mjeku për të kontrolluar shëndetin tuaj seksual dhe atë riprodhues (rrumbullakosni)?

- a) Kurrë
- b) Një herë në vit
- c) Disa herë në vit
- d) Një ose disa herë në muaj

DHUNA

Q 12. Më poshtë përshkruhen situata të dhunës, në të cilat mund ta gjejnë veten të rinjtë/rejat me bashkëmoshatarët/et e tyre. Shënoni me X në kutinë e përshtatshme dhe përgjigjuni deri në çfarë niveli keni marrë pjesë në një situatë të tillë, gjatë TRE MUJVE TË FUNDIT?

	DEKLARATA	Kurrë nuk ka ndodhur	Ka ndodhur një herë	Ka ndodhur një herë ose disa herë
1	Bashkëmoshatarët/et më kanë thirrur me nofka, janë tallur me mua, më kanë sharë apo kërcënuar.			
2	Bashkëmoshatarët/et më kanë goditur, më kanë dhënë shuplakë apo rrahur.			
3	Më kanë dërguar mesazhe kërcënuese apo ofenduese përmes SMS-ve, e-mail-it apo rrjeteve sociale.			
4	Më kanë sulmuar seksualisht, kundër vullnetit tim, ose më kanë prekur në trup në pjesë intime, çka më ka acaruar.			
5	Një grup bashkëmoshatarësh/esh më kanë sulmuar dhe kanë qenë të dhunshëm ndaj meje.			
6	Unë i kam thirrur bashkëmoshatarët/et me nofka, jam tallur me ta apo i kam sharë.			
7	Unë iu kam dhënë shuplakë, i kam goditur apo rrahur bashkëmoshatarët/et e të tjerë/a.			
8	Unë iu kam dërguar mesazhe kërcënuese apo ofenduese bashkëmoshatarëve/eve të mi/a përmes SMS, e-mail-it apo rrjeteve sociale.			
9	Unë kam sulmuar seksualisht ose i kam prekur në vende intime të trupit njerëzit e tjerë, kundër vullnetit të tyre.			
10	Si anëtar/e e grupit të bashkëmoshatarëve/eve, kam marrë pjesë në një akt të dhunshëm.			
11	Kam ofenduar verbalisht ose kam goditur dikë, të cilin kam menduar se është gej (homoseksual/lezbike).			

Q 13. Çfarë do të bënit, nëse do të ishit i pranishëm në një skenë rrahjeje mes një personi që e njihni dhe një personi tjetër (rrumbullakosni një përgjigje)?

- a) Do të provoja ta ndaloja sherrin
- b) Do t'i bashkohesha rrahjes, për të ndihmuar personin që e njoh
- c) Do të kërkoja ndihmë
- d) Nuk do të bëja asgjë

Q 14. Pyetje që lidhen me përvojën tuaj me dhunën, në një lidhje romantike/emocionale që mund të kesh pasur me partnerin/en tënd/e, janë dhënë në tabelën e mëposhtme. Nëse deri tani nuk keni pasur të dashur, mund ta tejkaloni tabelën e të kaloni në pyetjen tjetër.

PYETJET		Kurrë	Një herë	Një ose disa herë
1	A e keni sharë apo poshtëruar ndonjëherë të dashurin/ën tuaj?			
2	A e keni kufizuar apo ia keni ndaluar të dashurit/ës të komunikojë me shoqërinë, të dalë, për mënyrën si vishet dhe të tjera të ngjashme?			
3	A i keni dhënë ndonjëherë shuplakë apo e keni goditur të dashurin/ën tuaj?			
4	A keni bërë ndonjëherë seks me të dashurin/ën tuaj kundër vullnetit të tij/saj?			
5	A ju ka sharë apo poshtëruar ndonjëherë i/e dashuri/a juaj?			
6	A ju ka kufizuar apo ndaluar i/e dashuri/a juaj të komunikoni me shoqërinë, të dilni, për mënyrën e veshjes etj?			
7	A ju ka dhënë ndonjëherë shuplakë apo goditur i/e dashuri/a juaj?			
8	A ka bërë seks ndonjëherë i/e dashuri/a juaj me ju kundër vullnetit tuaj?			

Q 15. Nëse keni përjetuar dhunë në një lidhje intime, si keni reaguar në atë situatë (rrumbullakosni)?

- a) Në mënyrë të suksesshme e kam zgjidhur situatën, duke e mbrojtur veten ose duke e shmangur dhunën.
- b) Nuk kam arritur ta parandaloj dhunën. Kam qenë viktimë e dhunës.
- c) Nuk kam përjetuar dhunë në lidhje, prandaj nuk kam reaguar.

**Kemi ardhur në fund të pyetësorit.
Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj!**

Aneksi 2

Shembull i formës së pëlqimit

Formë pëlqimi për pjesëmarrje në hulumtimin Programi Y

Qëllimi

Jemi duke bërë një studim, për të kuptuar më shumë rreth asaj se si mendojnë djemtë dhe vajzat për mënyrën e sjelljes së tyre në shoqëri: si ata duhet të sillen dhe se si sillen, në lidhje me jetesën e shëndetshme, dhunën, barazinë gjinore, shëndetin seksual dhe riprodhues. Po ashtu, jemi të interesuar të mësojmë për çështjet me të cilat përballen burrat e rinj dhe gratë e reja në Ballkan, si dhe si mendojnë ata/ato për jetën dhe jetesën e tyre.

Ky studim kryhet në të gjitha shkollat dhe ambientet ku është duke u implementuar Programi Y, me mbështetjen e Ministrisë së Arsimit.

Nëse dëshironi të merrni pjesë në studim, kemi krijuar një pyetësor të shkurtër rreth këtyre temave. Pyetësori është personal, çka do të thotë se mund ta mbushni vetë, dhe se në të nuk do të përfshihet emri juaj, por vetëm një numër identiteti.

Do t'ua dorëzoj këtë pyetësor atyre që japin pëlqimin për të marrë pjesë në studim. Jam në gatishmëri t'ua përgjigjem të gjitha pyetjeve që mund të keni. Pyetësori do t'ju marrë rreth një orë kohë për ta plotësuar. Nëse vendosni të mos merrni pjesë, kërkojmë nga ju të qëndroni në dhomë e të lexoni ose të punoni në qetësi. Ose, nëse preferoni, një dhomë tjetër është e gatshme për ju për të lexuar apo punuar.

Pjesëmarrja vullnetare

Pjesëmarrja në këtë studim është plotësisht vullnetare. Nëse pranoni ta mbushni pyetësorin, mund të ndaloni kurdo që ju dëshironi, pa pasur nevojë të jepni ndonjë shpjegim dhe pa asnjë rezultat negativ. Më tutje, nuk jeni të detyruar të përgjigjeni në pyetje që ju bëjnë të ndiheni jo mirë, si dhe nuk jeni të detyruar të shpjegoheni pse nuk dëshironi të përgjigjeni. Nuk do të ketë asnjë rezultat negativ, nëse nuk përgjigjeni. Do të jem këtu përgjatë kohës së ndarë për plotësimin e pyetësorit, prandaj mund të më pyesni për çfarëdo pyetje, nëse keni nevojë për më shumë informacion apo çfarëdo tjetër.

Konfidencialiteti

Informacionet që ndani me ne në këtë pyetësor nuk do të shihen apo komentohen publikisht. Asnjë informacion identifikues nuk do të mbahet në format e pyetësorit. Një formë e veçantë do të përdoret për të bashkuar emrin tuaj me numrin identifikues të pyetësorit. Këtë informacion e mbledhim në mënyrë që të mund ta bashkojmë këtë pyetësor me një tjetër pyetësor, që ndoshta do ta plotësosh në fund të vitit shkollor. Vetëm ekipi hulumtues

do t'i ketë informacionet që bashkojnë numrin identifikues të pyetësorit tuaj me emrin tuaj. Pyetësorët do të mbahen në një vend të izoluar dhe në përfundim do të asgjësohen. Konfidencialiteti varet edhe nga ju vetë, pasi ju nuk duhet t'i ndani informacionet tuaja me askënd, përveç njerëzve tuaj të besueshëm.

Rreziqet

Disa pyetje në pyetësor mund t'ju turpërojnë apo t'ju bëjnë të ndiheni jo rehat, apo mund të sjellin përjetime ose kujtime të hidhura. Nuk jeni të detyruar t'i përgjigjeni asnjë pyetjeje që nuk dëshironi. Para pyetësorit, do t'ju dhuroj një listë me emra dhe kontakte të njerëzve apo organizatave në komunitetin tuaj që mund t'ju ndihmojnë, nëse do të keni nevojë. Këta janë njerëzit, me të cilët mund të flisni rreth asaj se si ndiheni kur i lexoni pyetjet.

E drejta për të refuzuar apo për t'u tërhequr

Ju mund të zgjidhni, nëse dëshironi apo jo të jeni pjesë e këtij studimi. Nuk ka dënime, nëse vendosni të mos merrni pjesë në hulumtim. Po e përsëris, nëse merrni pjesë, mund të vendosni të mos u përgjigjeni pyetjeve të caktuara apo edhe të ndaloni në çfarëdo kohe.

Nëse jeni të interesuar për pjesëmarrje, do t'ju kërkoja ta nënshkruani këtë formë. Mund të keni një kopje të saj, nëse dëshironi.

Pajtim për pjesëmarrje

Kam lexuar/më është shpjeguar e gjitha kjo formë e pëlqimit dhe kam marrë përgjigje të kënaqshme në secilën pyetje.

Pajtohem të marr pjesë në hulumtim Po Jo

Nënshkrimi i të anketuarit Data

Nënshkrimi i të anketuarit Data

Dua një kopje të formës së pëlqimit. Po Jo

Deklarata e hulumtuesit:

Unë, i poshtëshënuari, ia kam shpjeguar subjektit në gjuhën që ai e kupton procedurat që duhen ndjekur në këtë hulumtim, si dhe rreziqet dhe dobitë e përfshira. Ai ka dhënë pëlqimin e tij për të marrë pjesë në hulumtim.

Nënshkrimi i hulumtuesit Data

Aneksi 3

Shembull i listës së mekanizmave referues

1. Policia e Shqipërisë – 129

Policia rrugore: 126

Numri i shërbimeve të emergjencës në të gjithë Europën, përfshirë Shqipërinë – 112

2. Qendra klinike

Ndihma e shpejtë/ Ambulanca – 127

QSUT (Qendra Spitalore Universitare ‘Nënë Tereza’) Konsulta Ambulatore – 0800 28 28

3. Zjarrëfikësja – 128

4. Qendra për Këshillim dhe Testim vullnetar të HIV/AIDS

Qendra Rinore “PO”

Tel: 04 225 3839

E – mail: qendrapo@gmail.com

Adresa: Bulevardi: “Gjergj Fishta”, Tel: 042 253 839 Kompleksi “Tirana 2000”, Kulla 8, Kati 2. Tirana, Albania

Website: <http://acpd.org.al/>

Orari i punës: E Hënë – E Premte: 09:00 – 17:00

Qendra Aksion Plus - Tiranë

Tel: +355696178959

E-mail: gencaxionp@albmail.com

Adresa: Rr. Nasi Pavllo, Nd. 25

Website: www.aksionplus.net

Orari i punës: E Hënë – E Shtunë : 08:30 AM – 13:00 PM

5. Qendra për abuzimin ndaj substancave

Qendra Aksion Plus - Tiranë

Tel: +355696178959

E-mail: gencaxionp@albmail.com

Adresa: Rr. Nasi Pavllo, Nd. 25

Website: www.aksionplus.net

Orari i punës: E Hënë – E Shtunë : 08:30 AM – 13:00 PM

Aneksi 4

Testi paraprak dhe post-testi për mësues

PROGRAMI Y – Qasjet Inovative në Parandalimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe në Jetesën e Shëndetshme

PYETËSOR PËR MËSUESË/E

Ky pyetësor përmban pyetje rreth fushave të ndryshme të jetës së nxënësve/eve të shkollave të mesme, siç janë shëndeti, dhuna, familja, raportet gjinore etj. Është e rëndësishme të jepen përgjigje të sinqerta në të gjitha pyetjet. Ky nuk është test i njohurive dhe nuk ka përgjigje të gabuara. Pyetësori mbushet në mënyrë të pavarur, duke rrumbullakosur apo shkruar përgjigjen e përshtatshme. **Pyetësori nuk duhet të nënshkruhet.**

Q 1. Seksi? a) Femër b) Mashkull

Q 2. Sa vjeç jeni? _____

Q 3. Prej sa vitesh punoni si mësëmdhënës/e apo jeni staf i shkollës? _____

Q 4. Ju lutemi, lexojini me kujdes deklaratat e mëposhtme. Duke shkruar me X në kutinë e përshtatshme, tregoni se deri në çfarë niveli pajtoheni me secilën prej deklaratave.

	DEKLARATA	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	As e vërtetë as e pavërtetë	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Roli më i rëndësishëm i një gruaje është të jetë një amvisë e mirë, të kujdeset për shtëpinë dhe të gatujë për familjen e saj.					
2	Ndërrimi i pelenave, larja dhe ushqyerja e fëmijëve janë përgjegjësi të nënës.					
3	Nëse një grua e tradhton burrin, ai është i justifikuar nëse e godet gruan.					
4	Një shuplakë e vetme është formë e dhunës.					
5	Për një djalë, është më e pranueshme të largohet nga mësimi sesa për një vajzë.					
6	Burri duhet të ketë fjalën e fundit për vendimet e shtëpisë.					
7	Do ta pranoja, nëse kam një shok gej.					
8	Është normale kur një burrë e godet gruan e tij, nëse ajo nuk do (nuk dëshiron) të bëjë seks me të.					
9	Do të ndihesha shumë keq, nëse biri im do të ishte homoseksual.					
10	Gruaja duhet ta tolerojë dhunën, në mënyrë që ta mbajë familjen të bashkuar.					
11	Përgjegjësia është e përbashkët, si e burrit edhe e gruas, për ta parandaluar shtatzëninë.					
12	Është normale që burrat të qajnë e t'i shprehin emocionet e tyre para të tjerëve.					
13	Është e pranueshme të godas apo të rrah një person gej, nëse flirton me mua.					
14	Kur një grua ngacmohet seksualisht, kryesisht ndodh për shkak të mënyrës se si ajo është veshur.					
15	Është normale që prindërit t'i godasin fëmijët e tyre, kur ata/o nuk sillen mirë.					
16	Karakteristikat më të rëndësishme të një burri janë forca fizike dhe fuqia.					
17	Sharjet verbale janë lloji i dhunës.					

Q 5. Shënoni me X në kutinë e përshtatshme, duke treguar çfarë mendoni apo ndjeni në raport me secilën prej deklaratave në vijim:

	DEKLARATA	Nuk pajtohem/E pavërtetë	Pajtohem/E vërtetë	Nuk jam i sigurtë/Nuk e di
1	Një grua ka më shumë shanse të mbetet shtatzënë në mes të ciklit menstrual.			
2	Testosteroni është hormon që ndikon në zhvillimin e karakteristikave sekondare mashkullore (si qimet e fytyrës, toni i zërit etj.).			
3	Njerëzit mund të infektohen me HIV, duke ndarë ushqimin me dikë që ka HIV.			
4	Të gjitha infeksionet seksualisht të transmetueshme kanë simptoma që shihen me sy të lirë.			
5	Ndalimi i marrëdhënies seksuale është mënyrë tepër e besueshme për të parandaluar shtatzëninë.			
6	Tabletat Emergjente Kontraceptive (ECPs) nuk duhet të përdoren si metodë e zakonshme kontraceptive, por vetëm në situatë emergjente.			
7	Trupi i gruas absorbon më shumë alkool sesa një burrë që pi po të njëjtën sasi alkooli.			
8	Alkooli është drogë.			
9	Halucinogjenet janë lloj i drogës që e zvogëlon aktivitetin e trurit, duke shkaktuar përtaci dhe mungesë interesi.			
10	Njerëzit që tymosin marihuanë për një kohë të gjatë, kanë më shumë gjasa të zhvillojnë sëmundje, si kollitja permanente apo kanceri i mushkërive.			

Q 6. Ju lutemi, lexojini me kujdes deklaratat në vijim. Duke shënuar me X në kutinë e përshtatshme, tregoni deri në çfarë niveli pajtoheni me secilën prej deklaratave.

	DEKLARATA	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	As e vërtetë as e pavërtetë	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Nganjëherë dhuna është e vetmja mënyrë për të zgjidhur disa probleme.					
2	Dhunë është edhe kur dikush aksidentalisht godet dikë me krahë, në mënyrë që personi tjetër të ndjejë dhimbje.					
3	Dhunë është edhe sharja, dhe poshtërimi ndaj dikujt.					
4	Nuk mund të themi se një burrë është i dhunshëm, vetëm nëse i jep një shuplakë një gruaje.					
5	Në disa raste të dhunës ndaj grave, gratë kanë qenë fajtores ose e kanë pasur hak.					
6	Dhuna ndaj homoseksualëve nganjëherë justifikohet.					
7	Është normale për një nxënë të shkollës së mesme të pijë ndonjëherë alkool.					
8	Mbështes të rinjtë për të provuar marihuanën.					

Q 7.A keni parë në gjashtë muajt e fundit ndonjë nga rastet në vijim në shkollën tuaj? Shënoni me X në kutinë e përshtatshme për secilën situatë të përshkruar.

	DEKLARATA	Kurrë nuk ka ndodhur	Ka ndodhur njëherë	Ka ndodhur dy ose më shumë herë
1	Një djalë ka poshtëruar ose sharë një tjetër djalë.			
2	Një djalë ka goditur ose sharë një tjetër djalë.			
3	Një djalë ka poshtëruar ose sharë një vajzë.			
4	Një djalë ka goditur ose rrahur një vajzë.			
5	Një vajzë ka poshtëruar ose sharë një tjetër vajzë, ose djalë.			
6	Një vajzë ka goditur ose rrahur një tjetër vajzë, ose djalë.			
7	Rrahje fizike mes të dy ose më shumë grupeve të nxënësve.			
8	Një nxënës ka abuzuar verbalisht apo fizikisht dikë që ai/ajo ka menduar se ishte gej (homoseksual ose lezbike)			
9	Një mësues ka sharë verbalisht një nxënës.			
10	Një mësues ka sulmuar fizikisht një nxënës.			
11	Një nxënës ka sharë verbalisht një mësues.			
12	Një nxënës ka sulmuar fizikisht një mësues.			

Q 8. Cili është opinioni juaj i përgjithshëm rreth dhunës midis nxënësve të shkollës suaj (rrumbullakosni vetëm një përgjigje)?

- a) Nuk ka dhunë në shkollën tonë
- b) Dhuna ndodh shumë rrallë
- c) Dhuna ndodh ndonjëherë
- d) Dhuna ndodh shpesh
- e) Dhuna ndodh pothuajse rregullisht

Q 9. A janë të gjithë të barabartë në trajtim, si nxënësit meshkuj ashtu edhe femra, në shkollën tuaj (rrumbullakosni vetëm një përgjigje)?

- a) Nxënësit meshkuj dhe femra trajtohen në mënyrë të njëjtë nga mësuesit/et e tyre.
- b) Djemtë inkurajohen të vlerësojnë dhe të zgjedhin profesione të zotëruara nga burrat.
- c) Djemtë inkurajohen të vlerësojnë dhe të zgjedhin profesione të zotëruara nga gratë.

Q 10. Cili është opinioni juaj rreth nevojës dhe idesë se nxënësit duhet të aftësohen që në shkollën fillore e të mesme me stilin e jetesës së shëndetshme (rrumbullakosni vetëm një përgjigje)

- a) Nuk është detyrë e shkollës apo e stafit të saj të kryejë edukimin për aftësinë jetësore.
- b) Është përgjegjësi e shkollës për të implementuar edukim për aftësinë jetësore.
- c) Shkollat duhet t'i edukojnë nxënësit rreth aftësive të rëndësishme jetësore.

Q 11. Deri në cilin nivel pajtoheni me deklaratat e ofruara, të cilat lidhen me aftësinë tuaj për të implementuar një program për aftësi jetësore në shkollë? Shënoni me X në kutinë e përshtatshme për secilën situatë të përshkruar.

	NDIHEM I/E AFTË TË REALIZOJ PROGRAME ME NXËNËSIT/ET E MIA, TË CILAT LIDHEN ME...	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	As e vërtetë as e pavërtetë	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Parandalimi i dhunës					
2	Shëndeti seksual dhe riprodhues					
3	Barazia gjinore					
4	Parandalimi i konsumimit të substancave psiko-aktive (alkooli, drogat etj.)					

**Kemi arritur në fund të pyetësorit.
Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj!**

Aneksi 5

Testi paraprak dhe post-testi për edukatorë bashkëmoshatarë

PROGRAM Y – Qasje Inovative në Parandalimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Promovimin e Jetesës së Shëndetshme të Burrave të Rinj dhe Grave të Reja

PYETËSOR PËR EDUKATORË BASHKËMOSHATARË

Ky pyetësor përmban pyetje rreth fushave të ndryshme të jetës së nxënësve/eve të shkollave të mesme, siç janë shëndeti, dhuna, familja, raportet gjinore etj. Është e rëndësishme të jepen përgjigje të sinqerta në të gjitha pyetjet. Ky nuk është test i njohurive dhe nuk ka përgjigje të gabuara. Pyetësori mbushet në mënyrë të pavarur, duke rumbullakosur apo shkruar përgjigjen e përshtatshme. **Pyetësori nuk duhet të nënshkruhet.**

Q 1. Seksi? a) Femër b) Mashkull

Q 2. Sa vjeç jeni? _____

Q 3. Ju lutemi, lexojini me kujdes deklaratat e mëposhtme. Duke shkruar me X në kutinë e përshtatshme, tregoni se deri në çfarë niveli pajtoheni me secilën prej deklaratave.

	DEKLARATA	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	As e vërtetë as e pavërtetë	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Roli më i rëndësishëm i një gruaje është të jetë një amvisë e mirë, të kujdeset për shtëpinë dhe të gatujë për familjen e saj.					
2	Ndërrimi i pelenave, larja dhe ushqyerja e fëmijëve janë përgjegjësi të nënës.					
3	Nëse një grua e tradhton burrin, ai është i justifikuar nëse e godet gruan.					
4	Një shuplakë e vetme është formë e dhunës.					
5	Për një djalë, është më e pranueshme të largohet nga mësimi sesa për një vajzë.					
6	Burri duhet të ketë fjalën e fundit për vendimet e shtëpisë.					
7	Do ta pranoja, nëse kam një shok gej.					
8	Është normale kur një burrë e godet gruan e tij, nëse ajo nuk do (nuk dëshiron) të bëjë seks me të.					
9	Do të ndihesha shumë keq, nëse biri im do të ishte homoseksual.					
10	Gruaja duhet ta tolerojë dhunën, në mënyrë që ta mbajë familjen të bashkuar.					
11	Përgjegjësia është e përbashkët, si e burrit edhe e gruas, për ta parandaluar shtatzëninë.					
12	Është normale që burrat të qajnë e t'i shprehin emocionet e tyre para të tjerëve.					
13	Është e pranueshme të godas apo të rrah një person gej, nëse flirton me mua.					
14	Kur një grua ngacmohet seksualisht, kryesisht ndodh për shkak të mënyrës se si ajo është veshur.					
15	Është normale që prindërit t'i godasin fëmijët e tyre, kur ata/o nuk sillen mirë.					
16	Karakteristikat më të rëndësishme të një burri janë forca fizike dhe fuqia.					
17	Sharjet verbale janë lloj i dhunës.					

Q 4. Shënoni me X në kutinë e përshtatshme, duke treguar çfarë mendoni apo ndjeni në raport me secilën prej deklaratave në vijim:

	DEKLARATA	Nuk pajtohem/E pavërtetë	Pajtohem/E vërtetë	Nuk jam i sigurtë/Nuk e di
1	Një grua ka më shumë shanse të mbetet shtatzënë në mes të ciklit menstrual.			
2	Testosteroni është hormon që ndikon në zhvillimin e karakteristikave sekondare mashkullore (si qimet e fytyrës, toni i zërit etj.).			
3	Njerëzit mund të infektohen me HIV, duke ndarë ushqimin me dikë që ka HIV.			
4	Të gjitha infeksionet seksualisht të transmetueshme kanë simptoma që shihen me sy të lirë.			
5	Ndalimi i marrëdhënies seksuale është mënyrë tepër e besueshme për të parandaluar shtatzëninë.			
6	Tabletat Emergjente Kontraceptive (ECPs) nuk duhet të përdoren si metodë e zakonshme kontraceptive, por vetëm në situatë emergjente.			
7	Trupi i gruas absorbon më shumë alkool sesa një burrë që pi po të njëjtën sasi alkooli.			
8	Alkooli është drogë.			
9	Halucinogjenet janë lloj i drogës që e zvogëlon aktivitetin e trurit, duke shkaktuar përtaci dhe mungesë interesi.			
10	Njerëzit që tymosin marihuanë për një kohë të gjatë, kanë më shumë gjasa të zhvillojnë sëmundje, si kollitja permanente apo kanceri i mushkërive.			

Q 5. Ju lutemi, lexojini me kujdes deklaratat në vijim. Duke shënuar me X në kutinë e përshtatshme, tregoni deri në çfarë niveli pajtoheni me secilën prej deklaratave.

	DEKLARATA	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	As e vërtetë as e pavërtetë	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Nganjëherë dhuna është e vetmja mënyrë për të zgjidhur disa probleme.					
2	Dhunë është edhe kur dikush aksidentalisht godet dikë me krahë, në mënyrë që personi tjetër të ndjejë dhimbje.					
3	Dhunë është edhe sharja, dhe poshtërimi ndaj dikujt.					
4	Nuk mund të themi se një burrë është i dhunshëm, vetëm nëse i jep një shuplakë një gruaje.					
5	Në disa raste të dhunës ndaj grave, gratë kanë qenë fajtores ose e kanë pasur hak.					
6	Dhuna ndaj homoseksualëve nganjëherë justifikohet.					
7	Është normale për një nxënës të shkollës së mesme të pijë alkool ndonjëherë.					
8	Mbështes të rinjtë për të provuar marihuanën.					

Q 6. Deri në cilin nivel pajtoheni me deklaratat e ofruara, të cilat lidhen me aftësinë tuaj për të implementuar një program për aftësi jetësore në shkollë? Shënoni me X në kutinë e përshtatshme, për secilën situatë të përshkruar.

	NDIHEM I/E AFTË TË REALIZOJ PROGRAME ME NXËNËSIT/ET E MIA, TË CILAT LIDHEN ME...	Plotësisht e pavërtetë	Kryesisht e pavërtetë	As e vërtetë as e pavërtetë	Kryesisht e vërtetë	Plotësisht e vërtetë
1	Parandalimi i dhunës					
2	Shëndeti seksual dhe ai riprodhues					
3	Barazia gjinore					
4	Parandalimi i konsumimit të substancave psiko-aktive (alkooli, drogat etj.)					

**Kemi arritur në fund të pyetësorit.
Faleminderit për bashkëpunimin dhe kohën tuaj!**

Aneksi 6

Pyetësi kualitativ për intervista me mësues

Udhërrëfyes për intervista me mësues të shkollave Programi Y

1. A mund të më ofroni një prapavijë të përvojës suaj me sistemin e shkollës, në të cilën punoni?
2. Sa kohë keni që jetoni në këtë komunitet/zonë?
3. Cilat janë disa nga sfidat kryesore, me të cilat përballen familjet (e nxënësve tuaj) në këtë zonë?
4. Kur keni filluar të punoni në këtë shkollë?
5. Cilat janë sfidat kryesore, me të cilat përballeni ju si mësues/e në këtë shkollë?
6. Çfarë keni vërejtur/vëzhguar rreth të rinjve në këtë shkollë?
 - › Performanca e tyre në shkollë/arsim
 - › Qëllimet/aspiratat e tyre
 - › Sfidat/problemet kryesore, me të cilat ata përballen
 - › Karakteristikat e djemve që iu ndihmojnë atyre për t'i tejkuluar sfidat
 - › Karakteristika të ambientit që i ndihmojnë ose i pengojnë ata për të arritur qëllimet e tyre
7. Cilat janë lidhjet ose ndikimet më kritike që kanë të rinjtë këtu?
 - › Raportet me bashkëmoshatarët
 - › Të rriturit që janë rol-model
 - › Mbështetja/ndikimi familjar
 - › Raportet me mësues/e
 - › Raportet me gra të reja
8. Cilat janë disa nga sfidat, me të cilat burrat e rinj përballen në këtë shkollë? Po në komunitet, në përgjithësi? Në shtëpitë e tyre?
 - › Shëndeti riprodhues seksual i burrave të rinj
 - › Raporti me gratë e reja
 - › Dhuna midis bashkëmoshatarëve
 - › Dhuna në komunitet (dhe dhuna në shtëpi)
 - › Sfidat të ndryshme për nxënës më të rinj. Më të moshuar

9. Çfarë keni vënë re rreth vajzave në këtë shkollë? Cilat janë disa nga sfidat, me të cilat përballen vajzat në këtë shkollë? Po në komunitetin e përgjithshëm? Në shtëpitë e tyre?
 - › Shëndeti riprodhues seksual
 - › Raporti me burrat e rinj
10. Programi Y shpreson të ndërtojë qëndrime dhe sjellje më të barabarta gjinore te djemtë dhe te vajzat, me shpresë për arritjen e shëndetit riprodhues të përmirësuar dhe zvogëlim të dhunës. Çfarë mendoni për këtë ide? A mendoni se ky lloj projekti mund të jetë i dobishëm? Pse dhe pse jo? Çfarë shqetësimesh keni rreth programit?
11. Çfarë aktivitete të tjera do të dëshironit të përfshinte programi?
12. A ka palë tjetër interesi (për shembull prindër, Ministria e Arsimit) që mendoni se duhet të angazhoheshin në kuadër të programit?
13. A ka ndonjë aktivitet, pjesë e të cilit do të donit të ishit, apo diçka tjetër që dëshironi ta organizoni me të tjerë?

Aneksi 7

Forma e raportimit për punëtori dhe aktivitete të kampanjës

Pasqyra kohore dhe raporti i seminareve/workshop-eve edukative

Data e implementimit		Emri, mbiemri i edukatorit/es		Emri i shkollës/institucionit		Raporti i punëtorive edukative			Numri i pjesëmarrësve			Përfundime dhe komente të rëndësishme nga realizimi i seminareve (problemet, sfida...)	
		Edukatori/ja 1	Edukatori/ja 2				Meshkuj	Femra	Gjithsej				
Nr.	Orari	Minut at	Tema e seminareve/workshop-eve	Klasa	Meshkuj	Femra	Gjithsej						
1.													
2.													
3.													
4.													
5.													
6.													
Nënshkrimi i edukatorit/es 1:							Nënshkrimi i edukatorit/es:						

Aneksi 8

Shembull i bazës së të dhënave për nxënës dhe mësues

Programi Y – lista e pjesëmarrësve

	Emri dhe Mbiemri	Mësimdhënësi/ja	Nxënësi	Klasa	Kontakti	Pjesëmarrja në punëtori	Pjesëmarrja në aktivitetet e fushatës
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							
8							
9							
10							
11							
12							
13							
14							
15							
16							
17							
18							
19							
20							
21							
22							
23							